

## VENDIM Nr. 1535

Për

### Fillimin e procesit të Konsultimit Publik të

### “Draft Rregullores për Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”

Në mbështetje të bazë të nenit 10 paragrafi 4, nenit 27, paragrafi 1), 2), 3) dhe 4), neni 81 paragrafi 1), neni 82 paragrafi 1) dhe nenit 83 paragrafi 1), të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar si - LKE*); nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L-038 për Shërbime Postare (*tutje referuar si - LSHP*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- |                       |            |
|-----------------------|------------|
| 1) z. Nijazi Ademaj,  | Anëtar     |
| 2) z. Hazir Hajdari,  | Anëtar     |
| 3) z. Bahri Anadolli, | Anëtar dhe |
| 4) z. Shqiprim Pula   | Anëtar     |

pas shqyrtimit të draft Rregullores të përgatitur nga grupi punues i ekspertëve të Autoritetit, vendosi si më poshtë:

## V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik të dokumentit ‘Draft Rregullorja për pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare’.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë **02 Prill 2020** dhe përfundon më **16 Prill, 2020**.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A R S Y E T I M

Neni 1 i Ligjit specifikon qëllimin e Ligjit si në vijim:

“Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.”

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: “Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t’i publikoj ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që me anë të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut, sipas nivelit të llogaritur mbi bazën e kësaj rregulloreje, të garantohet financimi i nevojshëm për mbulimin e kostove administrative të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si -Autoriteti*) për ushtrimin e veprimtarisë si organ kompetent në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Andaj, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

**Prishtinë, 02/04/2020**

**Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

#### **Aktvendimi i dërgohet:**

- Ofruesve të shërbimeve të Komunikimeve Elektronike
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike,
- Departamentit Ligjor,
- Arkivës së Autoritetit.